

VENDIM
Nr. 732, datë 8.12.2017

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 744, DATË 5.11.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, TË
OBJEKTIT "FAKULTETI I GJEOLOGJISË DHE MINIERAVE", TIRANË, NGA MINISTRIA E
ARSIMIT DHE SPORTIT/ UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, TE MINISTRIA E
DREJTËSISË, PËR GJYKATËN E LARTË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 744, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titull dhe kudo në përmbajtjen e vendimit, pas emërimit "Gjykatën e Lartë" shtohen fjalët "... dhe Shkollën e Magjistraturës ...".

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Nga sipërfaqja e truallit 12 478 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) m², e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, sipërfaqja prej 3 205 (tre mijë e dyqind e pesë) m² i kalon Shkollës së Magjistraturës për ndërtimin e godinës, sipas projektidesë bashkëlidhur këtij vendimi."

c) Në pikën 3, fjalët "... pikën 1 ..." zëvendësohen me "... pikat 1 dhe 1/1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Gjendja Ekzistuese



Zona e Konkursit
Competition Area

Gjykata e Lartë
Supreme Court

Shkolla e Magjistraturës
School of Magistrate





